



RAPORT MONITORIMI

# ANALIZË E SHPENZIMEVE FINANCIARE TË UNIVERSITETEVE PUBLIKE NË SHQIPËRI

1 SHTATOR 2019 - 31 GUSHT 2020

## **PËRMBAJTJA**

1. Çfarë përmban raporti?
2. Çfarë bëjnë bordet e administrimit?
3. Çfarë bën administratori i universitetit?
4. Metodologjia e përdorur
5. Opinioni i studentëve mbi tarifimin dhe transparencën e shpenzimeve të ial-ve
6. Analizë e shpenzimeve të 6 universiteteve publike
  - 6.1 Kategoria “ Shpenzime Personeli”
  - 6.2 Kategoria “ Investime”
  - 6.3 Kategoria “Blerje mallrash”
  - 6.4 Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”
  - 6.5 Kategoria “Bursa dhe transferta për subvencione të tjera
7. Portali u-transparenca.al
8. Pasqyrë e plotë e shpenzimeve të 6 universiteteve publike në periudhën 1 shtator 2019 – 30 gusht 2020
9. Skedat e transparecës
10. Gjetjet kryesore
11. Rekomandime

### **Realizuan:**

**Autor:** Rigels Xhemollari

### **Ekspërtë monitorimi:**

Besjana Hysa; Migel Zallemi; Ines Mulellari

Opinionet, gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk reflektojnë domosdoshmërisht ato të Fondacionit Friedrich Ebert. Publikimet e Fondacionit Friedrich Ebert nuk mund të përdoren për arsye komerciale pa miratim me shkrim.

# 1.

## ÇFARË PËRMBAN RAPORTI?

Qëndresa Qytetare është një organizatë e fokusuar tek fuqizimi i rolit të qytetarit në shoqëri dhe synon përmirësimin e qeverisjes nëpërmjet angazhimit dhe aktivizmit qytetar. Nisur nga mungesa e transparencës financiare dhe cilësia e dobët e shërbimeve ndaj studentëve në universitetet publike, ankesat e shumta prej tyre dhe tarifat e larta që aplikojnë universitetet, prej 3 vjetësh Qëndresa Qytetare me mbështetjen e Fondacionit Friedrich Ebert, realizon monitorim periodik të shpenzimeve të universiteteve publike.

Vlera e këtij monitorimi në mënyrë të vazhdueshme ka vendosur nën presion shpesh herë drejtuesit e universiteteve dhe Bordet e Administrimit për të ulur abuzimet dhe keqpërdorimin e të ardhurave që vijnë nga tarifat e studentëve, por ende vijon të mbetet problematike situata e transparencës së këtij procesi.

Në kuadër të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe ndryshimeve që institucionet e arsimit të lartë pësuan sa i takon menaxhimit financiar dhe administrimit, **Qëndresa Qytetare monitoroi gjashtë universitete publike** me fokus shpenzimet dhe nivelin e transparencës së tyre në raport me publikun dhe studentët për **periudhën 1 Shtator 2019 deri më 31 Gusht 2020**.

Ky monitorim shërben për të hedhur dritë mbi mënyrën se si janë shpenzuar të ardhurat që grumbullohen nga tarifat e studentëve dhe të ardhurat që vijnë nga buxheti i shtetit duke u munduar për t'i dhënë një përgjigje pyetjes nëse reflektohen nevojat reale të studentëve apo kemi të bëjmë me një administrim jo efektiv të buxhetit vjetor të universiteteve?

Gjithashtu kjo nismë adreson një problematikë për të cilën qeveria në "Paktin për Universitetin", ndër morri masa duke shkarkuar Anëtarët e Bordeve të Administrimit duke i zvendësuar me figura publike, si rezultat i presionit të lartë të studentëve për keq menaxhimin e parave dhe si reflektim i qeverisë për më shumë efikasitet në menaxhimin e parave nga Anëtarët e Bordeve përfaqësues të MASR. Pjesë e këtij monitorimi do të jetë impakti dhe efekti që ka pasur portali U-transparenca.al, një database që synonte të përmbante çdo informacion në lidhje me shpenzimet e universiteteve e cila erdhi si një ndër zgjidhjet që Minsitria e Arsimit propozoi për zgjidhjen e kësaj problematike në fillim të vitit 2019. Të dhënat cilësore të siguruar në rrugë

zyrtare do të ndërthuren me të dhënat sasiore të përfuara nga një sondazh kombëtar i realizuar me 444 studentë mbi shërbimet që marrin aktualisht në IAL-të publike, nevojat që ata kanë dhe opinionin e tyre mbi transparencën dhe llogaridhënien në aspektin e menaxhimit financiar të universitetit.

Qëndresa Qytetare nëpërmjet këtij monitorimi synon të nxisë llogaridhënien publike të universiteteve ndaj studentëve dhe të stimulojë një nivel më të lartë transparence dhe të ndikojë në përmirësimin dhe orientimin e shërbimeve e IAL-ve publike ndaj studentëve.





## 2.

### ÇFARË BËJNË BORDET E ADMINISTRIMIT?

**Bordi i Administrimit** është organi më i lartë kolegjal administrativ, i cili garanton përmbushjen e misionit të institucionit të arsimit të lartë, mbarëvajtjen financiare dhe administrative të tij. Bordi përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë, të punësuar me kohë të pjesshme.

3 (tre) Anëtarë, përfaqësues të institucionit publik të arsimit të lartë, përzgjidhen nga Senati Akademik i institucionit përkatës, 4 (katër) Anëtarë përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin do të jenë ekspertë të njohur nga fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike e juridike dhe emërohen nga ministri përgjegjës për arsimin.

Përbërja e Bordit të Administrimit përcaktohet në varësi të planit buxhetor afatmesëm të institucionit publik të arsimit të lartë, të miratuar nga Bordi i Administrimit. Një nga Anëtarët përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin përzgjidhet nga studentët e IAL-së përkatëse, të cilët i paraqesin ministrit tri kandidatura.

Ministri i Arsimit emëron një prej kandidaturave të paraqitura nga studentët. Kandidaturat e paraqitura nga studentët duhet të plotësojnë të njëjtat kritere si edhe Anëtarët e tjerë të Bordit, përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Ministri përgjegjës për arsimin emëron Anëtarët e Bordit për secilin institucion të arsimit të lartë.

## 3.

### ÇFARË BËN ADMINISTRATORI I UNIVERSITETIT?

**Administratori** është autoriteti më i lartë administrativ dhe përgjegjës për mirëfunksionimin financiar të institucionit. Ai është përfaqësues ligjor i universitetit për çështjet financiare dhe administrative. Në institucionet publike të arsimit të lartë, ai përzgjidhet me konkurs të hapur, sipas kritereve të përcaktuara nga Bordi i Administrimit. Lista e kandidaturave që plotësojnë kriteret miratohet nga Senati Akademik. Emërimi i administratorit bëhet nga Bordi i Administrimit.

Në institucionet jopublike të arsimit të lartë, administratori emërohet dhe shkarkohet sipas përcaktimeve në statutin e institucionit. Administratori i institucionit publik të arsimit të lartë shkarkohet nga Bordi i Administrimit me 2/3 e votave të anëtarëve të tij.

Çdo Fakultet cakton Administratorin e tij, i cili është përgjegjës për mbarvajtjen dhe mirëfunksionimin e shërbimeve dhe administratës joakademike në fakultete si zyrat e sekretarisë, IT-së, bibliotekës dhe shërbimeve të tjera.

## 4.

### METODOLOGJIA E PËRDORUR

Ekipi i monitoruesve të Qëndresës shfrytëzoi dhe gërshetoi një sërë burimesh të informacionit. Monitorimi u bazua në analizën ligjore të zbatimit të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë sa i përket organeve të administrimit financiar në universitete dhe shqyrtimit të të dhënave të përfituara nga **transaksionet e thesarit**.



Gjetjet e analizuara të transaksioneve të thesarit u pasuruan me të dhënat e përfituara nga shfletimi i **buletinit të prokurimeve publike**, ku duken qartazi kontrata dhe objektet e marrëveshjeve që titullarët e universiteteve publike lidhin me operatorë të tretë për shërbime dhe produkte në plotësim të nevojave të universitetit.



AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Njëkohësisht, plot **20 kërkesa për informacion** drejtuar universiteteve të përzgjedhura u dërguan në lidhje me buxhetin, investimet dhe destinacionin e parave të mbledhura nga tarifat e studentëve. Në konsideratë janë marrë për raport krahësor edhe **gjetjet e raportit të KSLH** "Shërbimet Studentore në IAL-të publike".

Për të matur imapktin dhe efektin e drejtpërdrejtë të shpenzimeve tek shërbimet që përfitojnë studentët, pjesë integrale e këtij monitorimi u bë edhe një pyetësor me 444 studentë, të cilët shprehën opinionet e tyre mbi shërbimet e përfituara gjatë periudhës së monitorimit.

---

Në shqyrtim janë marrë të dhënat e 6 universiteteve publike dhe 11 njësive kryesore të Universitetit të Tiranës konkretisht:

**Universiteti i Tiranës (U.T)**

**Univeristeti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan (U.E),**

**Universiteti i Korcës (U.K),**

**Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës (UAMD),**

**Universiteti “Luigj Gurakuqi” Shkodër (U.SH),**

**Universiteti Politeknik i Tiranës (UPT)**

**Fakulteti i Drejtësisë UT**

**Fakulteti i Shkencave Sociale UT**

**Fakulteti i Ekonomisë UT**

**Fakulteti i Gjuhëve të Huaja UT**

**Fakulteti i Histori Filologjisë UT**

**Fakulteti i Shkencave të Natyrës**

**Instituti i Studimeve Europiane UT**

**Instituti Konfuci UT**

**Instituti i Fizikës Bërthamore**


**Filiali i UT Sarandë**

---

## 5. OPINIONI I STUDENTËVE MBI TARIFIMIN DHE TRANSPARENCËN E SHPENZIMEVE TË IAL-VE

Nisur nga fakti që tarifat tavan të nivelit bachelor vendosen nga qeveria dhe tarifat e nivelit master përcaktohen nga vetë strukturat universitare, pa u bazuar në një analizë kostoje transparente, studentëve iu drejtua pyetja: “A mendoni se universiteti ku ju studioni ofron shërbimet në raport të drejtë me pagesën që ju kryeni?”. 56% e studentëve shprehen se Universiteti nuk ofron shërbime në raport të drejtë me tarifën, 33% e tyre pohuan se këto shërbime janë disi në raport me tarifiën, ndërsa 10% e studentëve mendojnë se universiteti ua kthen totalisht në shërbime tarifën që paguajnë.

**A mendoni se universiteti ku ju studioni ofron shërbimet në raport me pagesën që ju kryeni?**



Ndërkohë sipas sondazhit të Qëndresës Qytetare 94% e studentëve nuk janë të informuar mbi mënyrën se si shpenzohen paratë e universitetit ku studiojnë dhe vetëm 6% e tyre janë përgjigjur se kanë informacion mbi shpenzimet.

**A jeni të informuar se si shpenzohet paratë e univeritetit ku studioni?**



Me ndryshimet që pësuan në formatim Bordet e Administrimit në universitetet publike, një Anëtar duhej të zgjidhej nga studentët. Pavarësisht mënyrës se si u zhvillua ky process sipas sondazhit vetëm 26% e studentëve e njohin Anëtarin e Bordit që përfaqëson studentët, pjesa tjetër prej 74% nuk e njohin përfaqësuesin e tyre në këtë bord. Ky tregues le të kuptojë edhe dështimin e kësaj politike për të zgjedhur persona që realisht informojnë dhe komunikojnë me studentët në mënyrë periodike.

**A e njihni Anëtarin e Bordit Drejtues, përfaqësues i Studentëve?**





## 6. ANALIZË E SHPENZIMEVE TË 6 UNIVERSITETEVE PUBLIKE

Monitoruesit dhe ekspertët e Qëndresës Qytetare kanë kaluar në sitë dhe kanë përpunuar në mënyrë të thjeshtëzuar të gjitha transaksionet që kanë kryer gjashtë universitetet publike duke përfshirë të gjitha kategoritë e shpenzimeve gjatë periudhës **1 Shtator 2019 – 30 Gusht 2020, përkatësisht në një vit akademik të plotë.**

Nëpërmjet kalimeve të vlerave tek të tretët apo personelit, duke marrë në konsideratë edhe përshkrimin e çdo transaksioni, është bërë i mundur edhe evidentimi i pagesave dhe transfertave të dyshimta apo të pa justifikuar.

Ekipi i monitoruesve ka identifikuar një sërë transaksionesh të ndara sipas kategorive të cilat nuk përputhen as me vlerat normale të pagesave, as me nevojat që mund të ketë një universitet publik, parë në raport me buxhetin e tij total.

---

### Gjatë kësaj periudhe në këto 6 Universitete kanë shpenzuar në total:

Universiteti i Tiranës (U.T)  
2,397,994,374 lekë në **2729 transaksione**

Univeristeteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan (U.E)  
681,889,628 në **295 transaksione**

Universiteti Korcë (U.K)  
352,724,547 lekë në **287 transaksione**

Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD)  
902,127,345 lekë në **1122 transaksione**

Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër (U.SH)  
433,855,146 lekë në **291 transaksione**

Universiteti Politeknik i Tiranës UPT –  
1,089,248,290 lekë në **1809 transaksione**

---

## Sipas kategorive të shpenzimeve Universitetet kanë shpenzuar si më poshtë:

Kategori	U. "Fan Noli" Korçë	U. "Luigj Gurakuqi" Shkodër	U. Aleksandër Moisiu" Durrë	Universiteti i Tiranës	"Aleksandër Xhuvani" Elbasan	Universiteti Politeknik i Tiranës
II <b>Shpenzime personeli</b>	221,004,314	294,050,103	502,310,369	1,211,976,431	374,969,403	653,197,094
III <b>Investime</b>	4,992,459	13,346,078	213,891,615	496,124,843	33,769,424	154,341,294
IV <b>Blerje mallrash</b>	12,662,983	30,668,855	76,107,895	169,801,341	40,164,372	47,676,654
V <b>Sigurimi i shërbimeve</b>	22,382,838	45,571,035	35,357,039	184,962,012	98,331,814	77,609,878
VI <b>Transferta dhe Subvencione</b>	272,182	4,536,348	4,286,448	28,296,332	1,416,163	64,934,145
VII <b>Të tjera</b>	48,288,552	45,682,727	70,173,979	306,833,415	133,238,452	91,489,225
<b>Totali</b>	<b>309,603,328</b>	<b>433,855,146</b>	<b>902,127,345</b>	<b>2,397,994,374</b>	<b>681,889,628</b>	<b>1,089,248,290</b>

Siç kuptohet edhe nga tabela, shpenzimet e universiteteve sipas zërave të kategorive shkojnë pak a shumë në proporcion të rregullt me shpenzimet totale të secilit prej tyre. Në të gjashtë universitetet e marrë në shqyrtim, pjesën thelbësore të shpenzimeve e zënë shpenzimet për personelin të kategorizuara në kategorin nr. 2, "Shpenzime Personeli" ndërsa pjesën më të vogël të shpenzimeve e zënë ato në kategorinë e nr.6, "Transferta dhe Subvencione".

### 6.1 Kategoria " Shpenzime Personeli"

Universiteti që ka bërë më shumë shpenzime për pagat ne total është Universiteti i Tiranës, i ndjekur nga UPT dhe me pas UAMD. Universiteti i Tiranës është edhe universiteti që ka shpenzimet më të larta për honorare dhe shpërblime në vlerën 213,671,100 lekë, ndërsa universiteti që ka shpenzuar më shumë për dieta, udhëtime dhe pagesa për Bordin e Administrimit, megjithëse rreth 50% e vitit të shkuar akademik ishte periudhë pandemie është Universiteti Politeknik i Tiranës.

Kategori/ Nënkategori	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korçes	U. Durrësit	U. Shkodres	Politeknik
<b>II Shpenzime personeli</b>	<b>1,211,976,431</b>	<b>374,969,403</b>	<b>221,004,314</b>	<b>502,310,369</b>	<b>294,050,103</b>	<b>653,197,094</b>
<b>2.1</b> Paga	959,046,943	369,147,397	209,371,336	469,623,261	265,638,478	532,685,761
<b>2.2</b> Honorare + Të tjera shpërblime për personelin	213,671,100	483,848	674,326	1,405,392	15,719,214	78,818,453
<b>2.3</b> Paga me kontratë për kohë të kufizuar	26,998,290	0	7,734,808	21,902,096	10,794,120	17,624,485
<b>2.4</b> Dieta Udhëtime	10,012,406	3,425,658	2,118,844	825,220	1,515,791	13,137,612
<b>2.5</b> Pagesa Anëtarët e Bordit Administrativ( + Senati)	2,247,692	1,912,500	1,105,000	8,554,400	382,500	10,930,783

## 6.2 Kategoria “ Investime ”

Universiteti i Tiranës ka shpenzimet më të larta për zërin e investimeve, ndjekur nga UAMD dhe UPT. Po ashtu edhe për zërin e pajisjeve dhe mobiljeve të zyrës konstatohen shpenzime shume të larta në UT, në vlerën e 51 milion lekëve të reja dhe më pas vjen UAMD i cili ka shpenzuar për këtë zë rreth 24 milion lekë të reja.

6 Universitetet e marra në monitorim kanë shpenzuar në total rreth 900 milion lekë të reja për zërin e investimeve, ku vetëm 4.7 milion, **apo 0.5% e parave kanë shkuar për zërin studime dhe kërkim shkencor.** Një vlerë e ulët por sërisht mbetet pozitive dhe shpresëdhënëse duke e krahasuar me vitet e shkuara, ku zëri “kërkime dhe studime” nuk përdorej nga universitetet. Për zërin e kërkimit shkencor kanë shpenzuar vetëm UPT, Universiteti i Elbasanit dhe ai i Korçës. Tre universitetet e tjera, që janë edhe konsumatorët më të mëdhenj të kësaj nënkategorie kanë shpenzuar 0 lekë për këtë zë.

<u>UNIVERSITETI “ALEKSANDËR MOISIU” DURRËS</u>	
1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor	Emri: Universiteti “Aleksandër Moisiu” Durrës Adresa: Lagjia Nr. 1, Rruga “Taulantia”, Currila, Durrës Tel/Fax: 0699690077 E-mail: ervis029@gmail.com Faqja e Internetit: <a href="http://www.uamd.edu.al">www.uamd.edu.al</a>
2. Lloji i procedurës së prokurimit:	Kërkese për propozim
3. Objekti i kontratës marrëveshjes kuadër: “Përmirësim i sistemit të mbrojtjes kundër zjarrit dhe sistemit të shpëtimit në Godinën Nr.1 të Kampusit Universitar dhe godinës Currila të Universitetit Aleksandër Moisiu, Durrës dhe realizimi i shkallës së emergjencës në godinën Currila.	
4. Numri i referencës së procedurës/lotit:	REF-68865-08-17-2020.
5. Fondi limit:	8.712.332 (tetë milion e shtatëqind e dymbëdhjetë mijë e treqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.
6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin:	60 ditë nga momenti i nënshkrimit të kontratës.
7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:	Datë 31/08/2020 Ora: 11:00 nëm adresë <a href="http://www.app.gov.al">www.app.gov.al</a>
8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje:	Datë 31/08/2020 Ora: 11:00 në adresën <a href="http://www.app.gov.al">www.app.gov.al</a>

Një shpenzim që bie në sy tek investimet është blerja e sistemit kundër zjarrit nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës, në vlerën 8.7 milion lekë të reja pa tvsh në muajin gusht 2020. Ky universitet nuk është rrezikuar më parë nga zjarri, nuk ka laboratore të shkencave mjekësore apo kimike dhe risku i zjarrit është shumë i ulët.

Kategori/Nënka tegori	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korces	U. Durrësit	U. Shkodres	U. Politeknik
<b>III Investime</b>	<b>496,124,843</b>	<b>33,769,424</b>	<b>4,992,459</b>	<b>213,891,615</b>	<b>13,346,078</b>	<b>154,341,294</b>
<b>3.1</b> Rikonstruksion i ndërtesave shkollore	351,544,791	31,783,424	0	175,168,120	7,386,250	92,182,623
<b>3.2</b> Pajisje pastrimi	0	0	0	0	0	0
<b>3.3</b> Mjete transporti (dhe Sherbime te tyre)	0	297,600	0	0	0	0
<b>3.4</b> Mjete dhe pajisje teknike	93,342,421	1,214,400	4,896,329	14,690,280	5,316,400	53,204,760
<b>3.5</b> Pajisje zyre dhe orendi të tjera	51,237,631	0	0	24,033,215	643,428	4,819,411
<b>3.6</b> Studime dhe kërkime	0	474,000	96,130	0	0	4,134,500

### 6.3 Kategoria "Blerje mallrash"

Universiteti i Tiranës është universiteti që ka shpenzuar më shumë për blerje mallrash me vlerën 169 milion lekë të reja u ndjekur nga UAMD me 76 milion dhe UPT me 48 milion leke te reja. Ndërkohë vetëm 3 nga 6 universitetet kanë shpenzuar para për karburant, ku spikat UAMD me 12.6 milion lekë të reja

karburant. Universiteti i Elbasanit "Aleksandër Xhuvani" vijon të shpenzojë shifra të larta dhe joproportionale me universitetet e tjera për ujin e pijshëm. Ky universitet së bashku me UPT kanë shpenzuar 0 lek për ngrohjen e hapësirave universitare në një vit akademik. Për vitin e dytë rresht universiteti "Lugij Gurakuqi" Shkodër ka shpenzuar 0 lek për të blerë libra, ndërsa 5 universitetet e tjera kanë shpenzuar nga 70 mij lek deri në 16.5 milion lekë për të blerë libra. Ekipi i Qëndresës Qytetare ka siguruar një dokument që tregon se vetëm nëpërmjet një prokurimi UAMD ka blerë rreth 5 milion lekë të reja karburant në muajin korrik, periudhë kur

Buletini Nr. 41 datë 06 Korrik 2020 Agjencia e Prokurimit Publik

**UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS**

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor  
 Emri: Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës  
 Adresa: Lagja Nr. 1, Rruga "Taulantia", Currika, Durrës  
 Tel/Fax: 0695690077  
 E-mail: [ervis@upm.edu.al](mailto:ervis@upm.edu.al)  
 Faqja ne Internet: [www.uam.edu.al](http://www.uam.edu.al)

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozim.

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Blerje karburanti për nevojat e Universitetit "Aleksandër Moisiu", Durrës".

4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-63296-06-30-2020

5. Fondi limit: 4.988.412 (katër milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind e dyndëdhjetë) lekë pa TVSH.

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 12 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 14.07.2020 ora 11.00 në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 14.07.2020 ora 11.00 në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**BASHKIA PRRËNJAS**

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor  
 Emri: Bashkia Prrënjës  
 Adresa: Rruga Skënderbej  
 Tel/Fax: 059124804/22605  
 Personi përgjegjës: A. Krasniqi  
 Nr i kontaktit: 0699109455  
 E-mail: [bashkiaprrenjasa@hotmail.com](mailto:bashkiaprrenjasa@hotmail.com)  
 Adresa e Internetit: -

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Kërkesë për propozim-mallra-elektronike

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Blerje bazë materiale për rikonstruksionin e banesave".

4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-63716-07-02-2020

universiteti punonte me kapacitete të kufizuara dhe studentët ishin kthyer në shtëpitë e tyre.

Kategori/Nënkategori	U. Tiranes	U. Elbasanit	U. Korces	U. Durrësit	U. Shkodres	U. Politeknik	
<b>IV</b>	<b>Blerje mallrash</b>	<b>169,801,341</b>	<b>40,164,372</b>	<b>12,662,983</b>	<b>76,107,895</b>	<b>48,058,230</b>	
<b>4.1</b>	Energji elektrike	23,485,237	7,297,237	3,679,791	18,555,118	6,521,351	16,196,175
<b>4.2</b>	Karburant dhe vaj	5,258,676	5,223,701	0	12,697,368	0	0
<b>4.3</b>	Ujë	6,077,863	5,958,528	552,686	601,848	1,624,116	3,350,902
<b>4.4</b>	Ngrohje + Pastrim	27,971,555	0	4,593,658	18,515,907	11,338,521	0
<b>4.5</b>	Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	31,702,125	5,441,147	0	10,732,520	2,540,540	10,814,941
<b>4.6</b>	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	10,351,606	3,699,750	343,140	1,661,634	87,960	645,660
<b>4.7</b>	Libra dhe publikime profesionale	16,597,758	1,493,300	72,000	341,640	0	2,256,840
<b>4.8</b>	Materiale dhe shërbime operative	19,197,689	1,072,790	885,120	9,311,860	200,167	2,017,640
<b>4.9</b>	Pajisje Informatike	29,002,832	9,118,833	2,215,080	0	8,297,400	8,481,576
<b>4.10</b>	Materiale të tjera	156,000	859,086	321,508	3,690,000	58,800	4,294,496

#### UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

- Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor  
Emri: Universiteti "Aleksander Moisiu" Durrës  
Adresa: Lagja Nr. 1, Rruga "Taulantia", Curria, Durrës  
Tel/Fax: 0695446454  
E-mail: farboja@hotmail.com  
Faqja e Internetit: www.uamd.edu.al
- Lloji i procedurës së prokurimit: Kërkese për Propozim
- Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Shërbime printimi".
- Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-08620-08-13-2020
- Fondi limitat 3.509.551.08 (tre milion e pesëqind e nëntë mijë e pesëqind e njëqind zero leke.) leke pa TVSH.

Buletini "Dëshmorët e Kombit", Kërkimi i Ministrave Tel: 355 4 22 77 510 <http://www.app.gov.al> 91/091


Buletini Nr. 55 datë 17 Gusht 2020 Agjencia e Prokurimit Publik

- Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 12 muaj duke filluar nga momenti i nënshkrimit të kontratës.
- Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Date 25.08.2020 ora 11.00 ne adresen [app.gov.al](http://app.gov.al).
- Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: Date 25.08.2020 ora 11.00 ne adresen [app.gov.al](http://app.gov.al).

Universitetet janë hapësisra ku nevoja për të printuar apo fotokopjuar është e lartë si nga ana e stafit administrativ ashtu edhe e studentëve. UAMD ka shpenzuar shifra të larta për të marrë këtë shërbim në operatorë të tretë. Sipas buletinit të prokurimeve publike në muajin gusht 2020 UAMD ka blerë 3.5 milion lekë të reja pa tvsh shërbime të jashtme printimi, ndërkohë që me një shumë të tillë mund të ishin blerë disa printera cilësorë në funksion të stafit akademik dhe studentëve.

Sipas sondazhit të realizuar me studentët, vetëm 6% e studentëve i kanë përdorur rregullisht fotokopjet dhe printerat që ndodhen në universitetin e tyre, ndërsa 94% kanë printuar dhe fotokopjuar materiale në kancelaritë pranë universitetit të tyre me paratë e tyre.

**Për të printuar dhe fotokopjuar materiale shkollore, ju përdorni:**





Nisur nga fakti që universitetet publike gjatë këtij viti akademik kanë pasur shpenzime të larta për blerjen e pajisjeve informatike ku vetëm UT ka shpenzuar 29 milion lekë të reja, Qëndresa Qytetare pyeti studentët lidhur me aksesin që ata kanë në këto pajisje. Sipas sondazhit, 60% e studentëve nuk i kanë përdorur asnjëherë kompjuterat dhe laboratorët e IT që ndodhen në universitetin ku studiojnë, 34% e tyre shprehen se i kanë përdorur vetëm disa herë dhe vetëm 6% deklarojnë se i përdorin shpesh pajisjet informatike të universitetit.

**Sa herë i keni përdorur kompjuterat dhe laboratorët e IT që ndodhen pranë universitetit tuaj:**



## 6.4 Kategoria “Sigurimi i Shërbimeve”

Nga monitorimi dhe evidentimi i transaksioneve dhe kontratave rezulton se drejtuesit e të gjitha universiteteve publike vazhdojnë të shpenzojnë shuma të mëdha të parave të studentëve për të lidhur kontrata për sigurinë e godinave. Universiteti i Tiranës ka shpenzuar në një vit akademik plot 65 milion

lekë të reja për siguri godine, ndjekur nga Universiteti i Elbasanit me rreth 50 milion lekë të reja siguri me roje. Për ilustrim po kemi vendosur në krah kontratën e lidhur me Universitetit të Korcës dhe një kompanie që ofron shërbimin e sigurisë së godinave në vlerën 17.5 milion lekë të reja pa tvsh, një vlerë goxha e lartë në raport me të ardhurat totale të këtij universiteti. Qëndresa Qytetare ka bërë transparente të gjitha transaksionet që universitetet

### UNIVERSITETI “FAN S.NOLI” KORÇË

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri: Universiteti “Fan S.Noli” Korçë  
 Adresa: Shëtitore: “Rilindasit”  
 Tel/Fax: 0822 42230  
 E-mail: rektorati@unkorce.edu.al  
 Faqja e Internetit: www.unkorce.edu.al

Emri dhe adresa e personave përgjegjës për prokurimin:

Emri: Florinda Zegullaj  
 Adresa: Korçë  
 Nr.tel: 0692410555  
 E-mail: zegullajflorinda@yahoo.com  
 Emri: Laureta Kokoneshi  
 Adresa: Korçë  
 Tel/Fax: 0822 42230  
 E-mail: loris20\_77@yahoo.it

2. Lloji i procedurës së prokurimit: Tender i hapur

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Shërbime të sigurimit e ruajtjes” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12,53 muaj (381 ditë).

4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-53604-03-10-2020

5. Fondi limit i marrëveshjes kuadër për 381 ditë (12,53 muaj): 17.480.097.76 (shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë mijë e nëntëdhjetë e shtatë pikë shtatëdhjetë e gjashtë) lekë pa TVSH

kanë shpenzuar për nënkategorinë “Sigurimi i Shërbimeve” për 1 vit akademik të plotë.

**UNIVERSITETI I TIRANËS**

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor  
Emri UNIVERSITETI I TIRANËS

---

Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Këshilli i Ministrave Tel.+ 355 4 22 77 510 <https://www.app.gov.al> 48/470

---

Buletini Nr. 39 datë 29 Qershor 2020 Agjencia e Prokurimit Publik

---

Adresa Blv. “Dëshmorët e kombit”, Sheshi “Nënë Tereza”, Tiranë  
Tel/Fax Tel. +35542258446  
E-mail s\_dafa@unitir.edu.al  
Faqja në Internet www.unitir.edu.al

2. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur

3. Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: “Mirëmbajtje e catise Rektoratit të UT-së”

4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-62774-06-25-2020

5. Fondi limit : 13.750.000 (trembëdhjetëmilion e shtatëqind e pesëdhjetëmijë) lekë pa TVSh.

6. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 60 ditë

7. Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 20.07.2020, Ora: 10:00


8. Afati kohor për hapjen e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje: 20.07.2020, Ora: 10:00

Universiteti i Tiranës ka shpenzimet më të mëdha për mirëmbajtje ndërtesash me vlerën prej rreth 45.7 milionë lekësh të reja. Ndërkohë bie në sy një shpenzim jo i vogël në vlerë, i Universitetit të Tiranës me përshkrimin “**Mirëmbajtje e çatisë së Rektoratit të UT-së**”, në vlerën 13 750 000 lekë pa tvsh, i publikuar në datën 29 qershor 2020 në buletinin e prokurimeve publike.

Kategori/Nënkategori	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korces	U. Durresit	U. Shkodres	U. Politeknik
<b>V Sigurimi i shërbimeve</b>	<b>184,962,012</b>	<b>98,331,814</b>	<b>22,382,838</b>	<b>35,357,039</b>	<b>45,571,035</b>	<b>77,228,302</b>
<b>5.1</b> Posta dhe shërbimi korrier	312,251	49,020	31,815	42,645	47,145	451104
<b>5.2</b> Telefon dhe internet	4,628,453	1,073,877	229,197	79,435	315,369	4,320,193
<b>5.3</b> Pastrim dhe gjelbërim	0	3,462,738	228,000	0	0	7,018,760
<b>5.4</b> Shërbime të tjera transporti	2,366,370	1,124,595	448,933	451,584	1,960	1,808,858
<b>5.5</b> Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	65,303,907	49,759,976	19,584,481	16,432,885	29,486,229	37,256,880
<b>5.6</b> Shërbime të tjera	38,792,197	2,529,600	64,150	221,260	0	1,276,682
<b>5.7</b> Aktivitete sociale për personelin (dhe pjesëmarrje në evente e konferenca)	11,822,137	1,295,240	406,530	455,400	18,960	3,998,900
<b>5.8</b> Mirëmbajtje ndërtesash	45,728,326	0	798,540	15,531,830	15,701,372	11,467,690
<b>5.9</b> Instalim dhe mirëmbajtje rjetash informatike	9,665,201	26,435,677	591,192	2,142,000	0	9,432,195
<b>5.10</b> Mirëmbajtje të tjera	6,343,170	12,601,091	0	0	0	197,040

6 universitetet e marra në monitorim kanë shpenzuar në total rreth 10 milion lekë të reja për zërin “Telefon dhe Internet”, ku kryesojnë UT dhe UPT me përkatësisht 4.6 dhe 4.3 milion. Ndërkohë 59% e studentëve të pyetur shprehen se nuk kanë akses në internet në hapësirat e universitetit të tyre dhe vetëm 32% e tyre pohojnë se pranë universitetit të tyre kanë akses në internet. 9% e studentëve nuk kanë informacion mbi këtë pyetje, pasi këta i përkasin kategorisë së studentëve të viteve të para, të cilët ende nuk kanë shkuar fizikisht në ambientet universitare. Ajo që bie në sy është edhe fakti që Universiteti i Shkodrës gjatë një viti akademik ka shpenzuar 0 lek për instalim ose mirëmbajtje rrjetash informatike, në një kohë kur mësimi po zhvillohet online dhe nevoja për to është e lartë.

**A keni akses të vazhdueshëm në internet në hapësirat e universitetit tuaj?**




### 6.5 Kategoria “Bursa dhe transferta për subvencione të tjera”

Përsa i përket mbështetjes së studentëve të dalluar dhe atyre në nevojë me bursa studimi, universitetet kanë shpenzuar shuma të konsiderueshme parash. Universiteti i Tiranës, që është edhe universiteti me më shumë studentë ka shpenzuar për zërin e bursave rreth 300 milion lekë të reja. Një tjetër shpenzim që rëndon mbi përgjegjësinë e drejtuesve të universitetit janë edhe shpenzimet gjyqësore për shkak të largimeve të padrejta nga puna, ku Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, Elbasan renditet i pari me 8 milion lekë të reja kompesim i ndjekur nga UAMD me 2.7 milion lekë kompesim nga vendimet gjyqësore.

	Kategori/Nënkategori	U. Tiranës	U. Elbasanit	U. Korces	U. Durrësit	U. Shkodrës	U. Politeknik
VI	<b>Transferta dhe Subvencione</b>	<b>28,296,332</b>	<b>1,416,163</b>	<b>272,182</b>	<b>4,286,448</b>	<b>4,536,348</b>	<b>64,934,145</b>
6.1	Tranferta për projekte	9,694,093	82,445	0	489,948	0	266,930
6.2	Kuota Antarësimi	15,428,454	140,064	0	0	0	5,379,730
6.3	Komisione Bankare	3,173,785	1,193,654	272,182	3,796,500	4,536,348	59,287,485
VII	<b>Të tjera</b>	<b>306,833,415</b>	<b>133,238,452</b>	<b>48,288,552</b>	<b>70,173,979</b>	<b>45,682,727</b>	<b>91,489,225</b>
7.1	Mbështetje e nxënësve të dalluar dhe bursa studimi	304,403,456	124,852,500	47,895,000	67,480,280	45,682,727	90,570,443
7.2	Shpenzime gjyqësore	2,429,959	8,385,952	393,552	2,693,699	0	918,782

## 7. PORTALI U-TRANSPARENCA.AL



Në përgjigje të një ndër kërkesave kryesore të protestës së studentëve në dhjetor 2018, qeveria nxorri VKM nr. 781 për garantimin e transparencës së institucioneve të arsimit të lartë, pavarësisht ekzistencës së ligjit për të drejtën e informimit dhe detyrimeve që ai parashikon për çdo autoritet publik.

Nga verifikimet e kryera nga ekipi i Qëndresës Qytetare ky portal nuk përmban të dhëna mbi shpenzimet në nivel unviersiteti apo rektorati por vetëm të dhëna në nivel fakulteti, gjë që u vështirëson studentëve të kuptojnë shpenzimet totale të unviersiteti dhe raportin e shpenzimeve për mënyrën se si harxhohen paratë e tyre.

Një tjetër mangësi e këtij protali janë prokurimet publike, ku për vitin 2020 nuk kemi të publikuar asnjë kontratë të lidhur nga asnjë universitet, ndërkohë që nga monitorimi ynë rezultojnë dhjetra kontrata të lidhura nga universitetet me operatorë privatë të tretë nëpërmjet procedurave të tenderimit.

Ndërsa sa i përket Vendimeve të organeve administrative dhe akademike janë publikuar vetëm ato vendime që kanë lidhje me bursat dhe tarifat, por jo vendime me efekt financiar dhe legjislativ brenda universitetit. Ndërkohë është përparuar lidhur me publikimin e cv-ve të pedagogëve në këtë portal, megjithëse ka ende mungesa.

Në pikën "gj" të këtij vendimi parashikohet se brenda u-transparenca.al do të gjenden edhe rezultatet e verifikimit të titujve akademike por jo vetëm që kjo kategori nuk është parashikuar dhe nuk ekziston në portal, por procesi i kontrollit anti- plagjiaturë nuk ka nisur ende të zbatohet për stafet akademike.



## 8. PASQYRË E PLOTË E SHPENZIMEVE TË 6 UNIVERSITETEVE PUBLIKE NË PERIUDHËN 1 SHTATOR 2019 – 30 GUSHT 2020

	Kategori/Nënkategori	Uni. Korces	Uni. Shkodres	Uni. Durrësit	Uni. Tiranës	Uni. Elbasanit	UPT
<b>II</b>	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>221,004,314</b>	<b>294,050,103</b>	<b>502,310,369</b>	<b>1,211,976,431</b>	<b>374,969,403</b>	<b>653,197,094</b>
2.1	Paga	209,371,336	265,638,478	469,623,261	959,046,943	369,147,397	532,685,761
2.2	Honorare + Te tjera shperblime per personelin	674,326	15,719,214	1,405,392	213,671,100	483,848	78,818,453
2.3	Paga me kontrate per kohe te kufizuar	7,734,808	10,794,120	21,902,096	26,998,290	0	17,624,485
2.4	Dieta Udhetime	2,118,844	1,515,791	825,220	10,012,406	3,425,658	13,137,612
2.5	Pagesa anetaret e bordit administrativ( + Senati)	1,105,000	382,500	8,554,400	2,247,692	1,912,500	10,930,783
<b>III</b>	<b>Investime</b>	<b>4,992,459</b>	<b>13,346,078</b>	<b>213,891,615</b>	<b>496,124,843</b>	<b>33,769,424</b>	<b>154,341,294</b>
3.1	Rikonstruksim i ndërtesave shkollore	0	7,386,250	175,168,120	351,544,791	31,783,424	92,182,623
3.2	Pajisje pastrimi	0	0	0	0	0	0
3.3	Mjete transporti	0	0	0	0	297,600	0
3.4	Mjete dhe pajisje teknike	4,896,329	5,316,400	14,690,280	93,342,421	1,214,400	53,204,760
3.5	Pajisje zyre dhe orendi të tjera	0	643,428	24,033,215	51,237,631	0	4,819,411
3.6	Studime dhe kërkime	96,130	0	0	0	474,000	4,134,500
<b>IV</b>	<b>Blerje mallrash</b>	<b>12,662,983</b>	<b>30,668,855</b>	<b>76,107,895</b>	<b>169,801,341</b>	<b>40,164,372</b>	<b>48,058,230</b>
4.1	Energji elektrike	3,679,791	6,521,351	18,555,118	23,485,237	7,297,237	16,196,175
4.2	Karburant dhe vaj	0	0	12,697,368	5,258,676	5,223,701	0
4.3	Ujë	552,686	1,624,116	601,848	6,077,863	5,958,528	3,350,902
4.4	Ngrohje + Pastrim	4,593,658	11,338,521	18,515,907	27,971,555	0	0
4.5	Kancelari, materiale zyre e të përgjithshme	0	2,540,540	10,732,520	31,702,125	5,441,147	10,814,941
4.6	Shpenzime per prodhim dokumentacioni specifik	343,140	87,960	1,661,634	10,351,606	3,699,750	645,660
4.7	Libra dhe publikime profesionale	72,000	0	341,640	16,597,758	1,493,300	2,256,840
4.8	Materiale dhe shërbime operative	885,120	200,167	9,311,860	19,197,689	1,072,790	2,017,640
4.9	Pajisje Informatike	2,215,080	8,297,400	0	29,002,832	9,118,833	8,481,576
4.10	Materiale të tjera	321,508	58,800	3,690,000	156,000	859,086	4,294,496
<b>V</b>	<b>Sigurimi i shërbimeve</b>	<b>22,382,838</b>	<b>45,571,035</b>	<b>35,357,039</b>	<b>184,962,012</b>	<b>98,331,814</b>	<b>77,228,302</b>
5.1	Posta dhe shërbimi korrier	31,815	47,145	42,645	312,251	49,020	451,104
5.2	Telefon dhe internet	229,197	315,369	79,435	4,628,453	1,073,877	4,320,193
5.3	Pastrim dhe gjelbërim	228,000	0	0	0	3,462,738	7,018,760
5.4	Shërbime të tjera transporti	448,933	1,960	451,584	2,366,370	1,124,595	1,808,858
5.5	Ruajtja dhe sigurimi i ndërtesave	19,584,481	29,486,229	16,432,885	65,303,907	49,759,976	37,256,880
5.6	Shërbime të tjera	64,150	0	221,260	38,792,197	2,529,600	1,276,682
5.7	Aktivitetet sociale per personelin (dhe pjesmarrje ne evente e konferenca)	406,530	18,960	455,400	11,822,137	1,295,240	3,998,900
5.8	Mirëmbajtje ndërtesash	798,540	15,701,372	15,531,830	45,728,326	0	11,467,690
5.9	Instalim dhe mirëmbajtje rrejtsh informatike	591,192	0	2,142,000	9,665,201	26,435,677	9,432,195
5.10	Mirëmbajtje të tjera	0	0	0	6,343,170	12,601,091	197,040
<b>VI</b>	<b>Transferta dhe Subvencione</b>	<b>272,182</b>	<b>4,536,348</b>	<b>4,286,448</b>	<b>28,296,332</b>	<b>1,416,163</b>	<b>64,934,145</b>
6.1	Tranferta për projekte	0	0	489,948	9,694,093	82,445	266,930
6.2	Kuota Antaresimi	0	0	0	15,428,454	140,064	5,379,730
6.3	Komisione Bankare/ te tjera tek individe	272,182	4,536,348	3,796,500	3,173,785	1,193,654	59,287,485
<b>VII</b>	<b>Të tjera</b>	<b>48,288,552</b>	<b>45,682,727</b>	<b>70,173,979</b>	<b>306,833,415</b>	<b>133,238,452</b>	<b>91,489,225</b>
7.1	Mbështetje e nxënësve të dalluar dhe bursa studimi	47,895,000	45,682,727	67,480,280	304,403,456	124,852,500	90,570,443
7.2	Shpenzime gjygesore	393,552	0	2,693,699	2,429,959	8,385,952	918,782
	<b>Totali</b>	<b>309,603,328</b>	<b>433,855,146</b>	<b>902,127,345</b>	<b>2,397,994,374</b>	<b>681,889,628</b>	<b>1,089,248,290</b>





## Universiteti i Tiranës

### Skeda e Transparencës

1 Shtator 2019 - 30 Tetor 2020

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

Krahësimi 2018-19

	<b>Siguri godine</b>	<b>527 000 €</b>		495 500 €
	<b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>37 400 €</b>		8 600 €
	<b>Studime dhe kërkime</b>	<b>0 €</b>		0 €
	<b>Libra dhe publikime</b>	<b>134 000 €</b>		936 €
	<b>Mjete transporti</b>	<b>0 €</b>		3 240 €
	<b>Karburant makine</b>	<b>42 470 €</b>		10 200 €
	<b>Pajisje zyre &amp; orendi</b>	<b>413 800 €</b>		194 000 €
	<b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>19 600 €</b>		95 300 €
	<b>Dieta/ Udhëtime</b>	<b>80 900 €</b>		12 700 €
	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>9 790 000 €</b>		
	<b>Shpërblime &amp; honorare</b>	<b>1 725 800 €</b>		

Totali nuk është shumësi e zerave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të përzgjedhura për të krahasuar

**Shpenzime totale në 1 Vit: 19 368 340 euro**



## Universiteti

### Politeknik i Tiranës

#### Skeda e Transparencës

1 Shtator 2019 - 30 Tetor 2020

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

Krahësimi 2018-19

	<b>Siguri godine</b>	<b>300 000 €</b>		340 000 €
	<b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>35 000 €</b>		35 400 €
	<b>Studime dhe kërkime</b>	<b>33 400 €</b>		12.600 €
	<b>Libra dhe publikime</b>	<b>18 000 €</b>		9 500 €
	<b>Mjete transporti</b>	<b>0 €</b>		3 000 €
	<b>Karburant makine</b>	<b>0 €</b>		71 130 €
	<b>Pajisje zyre dhe orendi</b>	<b>39 000 €</b>		145 140 €
	<b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>7 420 €</b>		2.000 €
	<b>Dieta/ Udhëtime</b>	<b>106 111 €</b>		135 536 €
	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>5 275 800 €</b>		4 450 631 €
	<b>Shpërblime dhe honorare</b>	<b>636 600 €</b>		

Totali nuk është shumësi e zerave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të përzgjedhura për të krahasuar

**Shpenzime totale në 1 Vit: 8 800 000 euro**



QENDRESA QYTETARE

FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG

# SKEDAT E TRANSPARECËS
























## Universiteti "Aleksandër Xhuvani" Elbasan

### Skeda e Transparencës

1 Shtator 2019 - 30 Tetor 2020

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

Krahësimi 2018-19

 <b>Siguri godine</b>	<b>401 905 €</b>		323 942 €
 <b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>8 673 €</b>		7 220 €
 <b>Studime dhe kërkime</b>	<b>3 828 €</b>		0 €
 <b>Libra dhe publikime</b>	<b>12 061 €</b>		13 565 €
 <b>Mjete transporti</b>	<b>2 400 €</b>		500 €
 <b>Karburant makine</b>	<b>42 191 €</b>		24 000 €
 <b>Pajsisje zyre &amp; orendi</b>	<b>0 €</b>		11 680 €
 <b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>67 700 €</b>		0 €
 <b>Dieta/ Udhëtime</b>	<b>27 700 €</b>		266 952 €
 <b>Shpenzime personeli</b>	<b>3 028 587 €</b>		2 557 723 €
 <b>Honorare &amp; shpërblime</b>	<b>3 900 €</b>		

Totali nuk është shumësi e zerave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të perzgjedhura për tu krahasuar

**Shpenzime totale në 1 Vit: 5 507 500 euro**























## Universiteti "Fan Noli" Korçë

### Skeda e Transparencës

1 Shtator 2019 - 30 Tetor 2020

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

Krahësimi 2018-19

 <b>Siguri godine</b>	<b>158 180 €</b>		160 000 €
 <b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>1 851 €</b>		1 983 €
 <b>Studime dhe kërkime</b>	<b>777 €</b>		2 800 €
 <b>Libra dhe publikime</b>	<b>560 €</b>		2 534 €
 <b>Mjete transporti</b>	<b>0 €</b>		4 300 €
 <b>Karburant makine</b>	<b>0 €</b>		29 676 €
 <b>Pajsisje zyre dhe orendi</b>	<b>0 €</b>		0 €
 <b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>3 178 €</b>		5500 €
 <b>Dieta/ Udhëtime</b>	<b>17 113 €</b>		25 400 €
 <b>Shpenzime personeli</b>	<b>1 785 000 €</b>		1 850 000 €
 <b>Shpërblime &amp; honorare</b>	<b>5450 €</b>		

Totali nuk është shumësi e zerave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të perzgjedhura për tu krahasuar

**Shpenzime totale në 1 Vit: 2 500 000 euro**



QENDRESA  
QYTETARE  
FRIEDRICH  
EBERT  
STIFTUNG



## Universiteti "Luigj Gurakuqi" Shkodër

### Skeda e Transparencës

1 Shtator 2018 - 30 Tetor 2019

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

Krahësimi 2018-19

	<b>Siguri godine</b>	<b>238 160 €</b>		246 954 €
	<b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>2 550 €</b>		2 941 €
	<b>Studime dhe kërkime</b>	<b>0 €</b>		0 €
	<b>Libra dhe publikime</b>	<b>0 €</b>		0 €
	<b>Mjete transporti</b>	<b>0 €</b>		24.000 €
	<b>Karburant makine</b>	<b>0 €</b>		14.680 €
	<b>Pajisje zyre dhe orendi</b>	<b>5 500 €</b>		389.000 €
	<b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>0 €</b>		0 €
	<b>Dieta/ Udhëtime</b>	<b>12 200 €</b>		53 114 €
	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>2 375 000 €</b>		1 800 942 €
	<b>Shpërblime &amp; honorare</b>	<b>127 000 €</b>		

Totali nuk është shumesi e zerave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të përzgjedhura për tu krahasuar

**Shpenzime totale në 1 Vit: 3 500 000 euro**



## Universiteti "Aleksandër Moisiu"

### Skeda e Transparencës

1 Shtator 2019 - 30 Tetor 2020

Disa nga kategoritë e shpenzimeve:

Krahësimi 2018-19

	<b>Siguri godine</b>	<b>132.726 €</b>		222 000 €
	<b>Telefon/ internet stafi</b>	<b>640 €</b>		2 950 €
	<b>Studime dhe kërkime</b>	<b>0 €</b>		0 €
	<b>Libra dhe publikime</b>	<b>2759 €</b>		6 160 €
	<b>Mjete transporti</b>	<b>0 €</b>		1 360 €
	<b>Karburant makine</b>	<b>102 555 €</b>		29 000 €
	<b>Pajisje zyre dhe orendi</b>	<b>194 113 €</b>		155 000 €
	<b>Shpenzime gjyqësore</b>	<b>21 756 €</b>		67 500 €
	<b>Dieta/ Udhëtime</b>	<b>6600 €</b>		27 400 €
	<b>Shpenzime personeli</b>	<b>4 057 106 €</b>		3 460 505 €
	<b>Shpërblime dhe honorare</b>	<b>11 351 €</b>		

Totali nuk është shumesi e zerave me sipër, ato janë një pjesë e shpenzimeve të përzgjedhura për tu krahasuar

**Shpenzime totale në 1 Vit: 7.286.385 Euro**



## 10. GJETJET KRYESORE

- Pavarësisht gjendjes së shkaktuar nga tërmetet dhe pandemia, gjatë vitit akademik 2019 – 2020 zyrtarët e Universitetit të Tiranës janë shpërblyer me rreth **1.7 milion euro honorare**, ndërsa ata të UPT kanë shpenzuar **106 000 euro për dieta dhe udhëtime**.
- Universiteti i Tiranës ka shpenzuar **413 Mije Euro për moblije dhe orendi zyre**, por **0 lek për zërin e studimeve dhe kërkimit shkencor**.
- 6 Universitetet e marra në monitorim kanë shpenzuar në total rreth 7.3 milion euro për zërin e investimeve, ku vetëm 38 000 euro, **apo 0.5% e parave kanë shkuar për zërin studime dhe kërkim shkencor**.
- 6 universitetet e marra në monitorim kanë shpenzuar në total rreth **80 000 euro për zërin “Telefon dhe Internet”**, ndërkohë që 59% e studentëve të pyetur shprehen se **nuk kanë akses në internet** në hapësirat e universitetit të tyre
- Universiteti i Tiranës ka shpenzimet më të larta për rikonstruksion dhe mirëmbajtje ndërtesash me vlerën prej rreth 3.7 milion eurosh, ku vetëm mirëmbajtja e **çatisë së Rektoratit të UT-së, ka kushtuar 111 000 euro**.
- Sipas sondazhit të Qëndresës Qytetare, **94% e studentëve** nuk janë të informuar mbi mënyrën se si shpenzohen paratë e universitetit ku studiojnë dhe **74% e tyre nuk e njohin** përfaqësuesin e tyre në Bordin e Admistrimit.
- Pavarësisht se 6 universitetet kanë shpenzuar **850 000 euro për mirëmbajtje rrjetesh dhe pajisje informatike**, vetëm **6% e studentëve deklarojnë se i përdorin shpesh pajisjet informatike të universitetit**. 60% e tyre nuk i kanë përdorur asnjëherë dhe 34% e studentëve shprehen se i kanë përdorur vetëm disa herë këto pajisje.
- Universiteti i Tiranës ka **shpenzuar 530 000 euro për sigurinë e godinave** në një vit akademik, ndjekur **nga Universiteti i Elbasanit me 400 000 euro** dhe Universiteti Politeknik i Tiranës me 300 000 euro pagesa për **sigurinë me roje të godinave universitare**.
- Universiteti i Shkodrës nuk ka bërë asnjë shpenzim për rrjetin informatike, ndërsa UAMD nuk ka bërë asnjë shpenzim për pajisje informatike, në një kohë kur nevoja për digjitalizimin e mësimin dhe shërbimeve është e madhe.



## 11. REKOMANDIME

- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të zbatojë plotësisht VKM 781, dt 26.12.2018 duke përditësuar dhe plotësuar me kategoritë që mungojnë protalin u-transparenca përfshi prokurimet për vitin 2020 dhe shpenzimet në nivel rektorati.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të inspektojë dhe monitorojë buxhetet, transaksionet dhe ofrimin e shërbimeve të universiteteve publike sipas parashikimeve të ligjit 80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor dhe të marrë masat e nevojshme administrative dhe ligjore në raste shkeljesh.
- Universitetet publike duhet të përditësojnë dhe personalizojnë programet e transparencës në zbatim të ligjit për të drejtën e informimit dhe të aplikojnë vendimarrje financiare të hapur me përfshirjen e studentëve.
- Universitetet publike duhet të reduktojnë dhe reformojnë strukturat organizative të fryra duke aplikuar njëkohësisht dixhitalizimin e shërbimeve për studentët.
- Universitetet publike duhet të alokojnë më shumë para për zërat e kërkimit shkencor, pasurimi të bibliotekave të tyre me librat që përmban kurrikula mësimore dhe më pak para për siguri godinash dhe orendi zyrash.
- Anëtarët e Bordit të Administritimit, përfaqësues të studentëve duhet të krijojnë platforma komunikimi me qëllim informimin e studentëve mbi shpenzimin e parave nga tarifat e tyre.
- Këshillat Studentore dhe studentët aktivë duhet të bëhen pjesë e vendimmarrjes duke verifikuar çdo blerje, çdo kontratë lidhur me të tretët dhe çdo shërbim të ofruar nga universiteti ku studiojnë.
- Këshillat Studentore dhe studentët të kërkojnë nga Anëtarët e Bordit të Administritimit të propozuar prej tyre llogari periodike për çdo veprim financiar që ka ndërmarrë universiteti.





